



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
THE MUNICIPALTY OF SUHAREKA
OPSTINE SUVA REKA



10/Nr.68

Suharekë, 12.05.2022

**FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTE PËR KULTURË, RINI DHE SPORT PËR VITIN
2022**

Komuna e Suharekës-Drejtoria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës bazuar në Rregulloren MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve fton të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës si dhe individët që veprojnë brenda Komunës së Suharekës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushat e Sportit, Rinisë, Kulturës që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në kulturë, rini dhe sport.

Qëllimi i ftesës publike është:

Subvencionimi për klubet sportive, OJQ-të rinore e kulturore si dhe individët për zhvillimin e aktiviteteve nga fushëveprimtaria e tyre.

Shuma minimale dhe maksimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt në fushat e caktuar :

Lot 1. Sporti: vlera minimale 1,000.00 € dhe maksimale 25.000,00 €.
Lot 2. Kultura: vlera minimale 1,000.00 € dhe maksimale 10.000,00 €.
Lot 3. Rinia: vlera minimale 1,000.00 € dhe maksimale 4.000,00 €.
Lot 4. Individ: vlera minimale 200 € dhe maksimale 1,000,00 €.

KRITERET E PËRGJITHSHME PËR OJQ-TË DHE INDIVIDËT:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

OJQ-të:

- të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës.
- të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga Komuna e Suharekës;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Individët:

- Të jetë i moshës mbi 18 vjeçar/e;
- Të jetë banor i Komunës së Suharekës;
- Të ketë kualifikim universitar;

KRITERET SPECIFIKE PËR OJQ DHE INDIVIDË

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar dhe të hyjë në fazën e vlerësimit nga aspekti përmbajtësor, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike
- të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre;
- i gjithë dokumentacioni duhet të përmbaj 3 kopje fizike.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme dhe specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

SHPENZIMET E PRANUESHME QË DO TË FINANCOHEN PËR KËTË THIRRJE PUBLIKE

Nëpërmjet fondeve publike të kësaj thirrjeje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në projekt do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike dhe sportive, aktivitetet për avokim, punëtori, tryeza, debate (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- Material shpenzues;
- Shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- Shërbimet e reklamimit (televizionit dhe radio prezantime, mirëmbajtjes së ueb faqeve, njoftimet në gazeta, materiale reklamuese, etj, duke përcaktuar llojin e promovimit, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve);
- Shpenzimet e pagesave për stafin e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat, individët dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara;
- Shpenzimet e transportit dhe udhëtimit;
- Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit (aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionit, qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit;

Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzimeve të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrjeje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë p.sh:

- Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- Kostot e blerjes së pajisjeve, mobileve, dhe punëve të vogla ndërtimore;
- Shpenzimet e interesit për borxhin;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- Pagesa e bonuseve për punonjësit;
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifatat për transferet financiare dhe tarifatat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- Donacionet bamirëse;
- Pagesa e qirasë së zyrave për veprimtarinë e organizatave ose individëve;
- Kredi për organizata të tjera apo individ;
- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;
- Kostot e paisjeve (Llaptop, kompjuter, printer, skaner, projektor etj).

KRITERET E VLERËSIMIT NGA ASPEKTI PËRMBAJTJESORË:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve të vlerësojë me sa vijon:

1. A posedon OJQ-ja përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit (duke përfshirë personelin, pajisjet dhe aftësinë për të udhëhequr me buxhetin si dhe referenca për projekte të ngjashme)?
2. A posedojnë trajnerët e angazhuar në projekt përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë publike)?
3. A ka një strukturë të qartë brenda OJQ-së që do të merret me menaxhimin e projektit (a është e përcaktuar qartë ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit) ?
4. Sa relevant është projekt-propozimi me qëllimin e ftesës publike?
5. A janë objektivat e projektit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
6. A janë aktivitetet e projektit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
7. A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe nëse aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?
8. A ka arritur projekti të përcaktojë në mënyrë të qartë përdoruesit (numrin, moshën, gjininë, etj)?
9. A përcakton dhe në çfarë mase adreson problemet dhe nevojat e tyre projekti?
10. A janë kostot e projektit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
11. A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit?

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është deri më 25 Maj 2022

OJQ –të dhe individët mund të aplikojnë **vetëm me një (1) projekt** në kuadër të kësaj thirrje (duke u përcaktuar vetëm për një lot).

Periudha e zbatimit të projektit është maksimum deri më 30 Dhjetor 2022

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Suharekë (<https://kk.rks-gov.net>)

Forma duhet të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Formulari i Aplikimit duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i organizatës për ojq si dhe individi.

Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

Dokumentacioni i shtypur në tre kopjeduhet të vendosen në një zarf të mbyllur me mbishkrimin **(Subvencionimi i OJQ-ve dhe individëve që ushtrojnë aktivitete në fushën e sportit, rinisë, kulturës në Komunën e Suharekës)**.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet **emri i thirrjes publike**, së bashku me emrin e plotë të institucionit që financon, adresën e aplikuesit dhe shënimin *"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues"*

KU TA DORËZONI APLIKIMIN?

Aplikacionet dorëzohen në zyrën nr.1 Komuna e Suharekë, çdo ditë pune prej orës 8⁰⁰ – 16⁰⁰.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftese publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Veretje!

Të gjitha ojq-të që nuk e kanë mbyllur raportin për vitin fiskal 2021 nuk do të subvencionohen.

DOKUMENTET E DOMOSDOSHME PËR APLIKIM PËR OJQ DHE INDIVID:

Ju lutemi bashkëngjitni këtij aplikacioni dokumentacionin dëshmuës
OJQ/Klubet sportive:
Formulari i Aplikacionit për Projekt <i>(e detyrueshme)</i> ;
Formulari i Buxhetit <i>(e detyrueshme)</i> ;
Deklaratë për projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin 2022 <i>(e detyrueshme)</i> ;
Deklaratë mbi financimin e dyfishtë <i>(e detyrueshme)</i> ;
Kopje e leternjoftimit valide për përfaqësuesin e autorizuar <i>(e detyrueshme)</i> ;
Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar më deklaratën nën betim) <i>(e detyrueshme)</i> ;
OJQ-ja aplikuese duhet të dërgojë kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit <i>(e detyrueshme)</i> ;
Numër Fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës me rastin e aplikimit OJQ-ja <i>(e detyrueshme)</i> ;
Letër konfirmim për personin e autorizuar të OJQ-së nga Ministria e Administratës publike <i>(e detyrueshme)</i> ;
Dëshminë (Konfirmimin) e xhirollogarisë aktive të aplikuesit (OJQ) në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
Dëshmi për pjesmarrje në gara sportive (Për klubet sportive) <i>(e detyrueshme)</i> ;
Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet Opcionale ;
Individ:
Formulari i Aplikacionit për Projekt <i>(e detyrueshme)</i> ;
Formulari i Buxhetit <i>(e detyrueshme)</i> ;
Deklaratë mbi financimin e dyfishtë <i>(e detyrueshme)</i> ;
Kopje e leternjoftimit valide <i>(e detyrueshme)</i> ;
Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar më deklaratën nën betim) <i>(e detyrueshme)</i> ;
Dëshminë (Konfirmim) e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë <i>(e detyrueshme)</i> ;